



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ)**, në mbështetje të nenit 64, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 dhe 2.2, nenit 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81 dhe 127, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), nenit 22 dhe 29, paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL), me datën 08.03.2024, miraton këtë:

## **RREGULLORE ZGJEDHORE NR.11/2024**

### **KËSHILLAT E VENDVOTIMEVE**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Kjo Rregullore përcakton mënyrën e themelimit, përbërjen dhe funksionet, nominimin nga subjektet politike, kualifikimin dhe kriteret për emërim të Këshillave të Vendvotimit (KVV), emërimin, zëvendësimin, përfundimin e mandatit, të drejtat, orarin e punës dhe vendimmarrjen e KVV.

#### **Neni 2**

#### **Përbërja e KVV**

1. KVV është trup menaxhues zgjedhor, i themeluar nga KQZ, i cili është përgjegjës për përgatitjen dhe administrimin e procesit zgjedhor në Vendvotim (VV).
2. Përbërja e KVV reflekton strukturën e anëtarëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ). KQZ duhet të bëjë përpjekje maksimale që të sigurojë përfaqësimin gjinor, së paku 30% në nivel komune, për secilin subjekt politik.
3. KVV përbëhet nga: Kryesuesi i KVV, kontrolluesi i rreshtit, zyrtari i identifikimit, zyrtari i të dhënave statistikore dhe dhënësi i fletëvotimit.
4. Përfundimisht paragrafit 3 të këtij neni, KQZ me vendim, mund ta rrisë (jo më shumë se 2 anëtarë) ose ta zvogëlojë (jo më shumë se 2 anëtarë) numrin e anëtarëve të KVV. Në këto raste, KQZ përcakton funksionet që do të ushtrohen nga anëtarët.
  - 4.1. Në rastin kur kemi më shumë se pesë (5) anëtarë në një KVV, anëtari i gjashtë (6) asiston dhënësin e fletëvotimit, ndërsa anëtari i shtatë (7) kryen funksionin e mbikëqyrësit të kutisë së votimit.

### **Neni 3**

#### **Përfaqësimi në KVV**

1. KQZ fton subjektet politike të certifikuara të cilat kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit nacionale, që të nominojnë nga një (1) anëtar për KVV.
2. KQZ kujdeset që të sigurojë përfaqësimin e drejtë në KVV, për të gjitha komunitetet, duke u bazuar në:
  - 2.1. Numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune;
  - 2.2. numrin e votave të subjekteve politike të secilit komunitet, në nivel vendi dhe në nivel komunal.
3. Subjektet politike të certifikuara, të cilat janë të përfaqësuara në nivel komunal, por që nuk përfshihen në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, ftohen që t'i dorëzojnë propozimet për anëtarë të KVV, sipas numrit të përcaktuar nga KQZ, sipas formulës për përfaqësim, e bazuar në përqindjen e votave të fituara në kuvendin komunal.
4. Në rast se kandidati i pavarur i zgjedhur si kryetar i komunës në zgjedhjet e fundit, garon sërish në zgjedhje për kryetar komune si kandidat i pavarur, të njëjtit i garantohet përfaqësimi me nga një (1) anëtar të KVV, në secilën KVV në atë komunë.
5. Nëse nuk plotësohet numri prej pesë (5) anëtarëve të KVV, KQZ mund të kërkojë nominime plotësuese nga subjektet politike të reja, të certifikuara për zgjedhje dhe organizatat jo qeveritare (OJQ), të cilat nuk monitorojnë zgjedhjet.
6. Në rastet e jashtëzakonshme, nëse numri i anëtarëve të KVV nuk arrihet të plotësohet sipas paragrafit 5 të këtij neni, KKZ mund t'i rekomandojë KQZ-së nominimin e personave të cilët kanë përvojë zgjedhore.
7. Kryesuesit e KVV zgjedhen në mënyrë të barabartë nga katër subjektet politike që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës në zgjedhjet e fundit në komunën përkatëse dhe që janë certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhjet aktuale.
8. Caktimi i kryesuesve të KVV, sipas paragrafit 7 të këtij neni, bëhet përmes formulës së rotacionit, të cilën e zbaton KKZ, sipas renditjes së votave që kanë fituar në zgjedhje.
9. Subjektet politike të certifikura me të drejtë nominimi për KVV, kanë të drejtë të nominojnë për emërim si anëtarë dhe kryesues rezervë 10% nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të tyre për KVV.

### **Neni 4**

#### **Përfaqësimi në raundin e dytë të zgjedhjeve**

1. Në raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunës, numri maksimal i anëtarëve të KVV është pesë (5) anëtarë.

- 1.1. Subjekteve politike të cilat janë në garë në raundin e dytë të zgjedhjeve, u garantohet përfaqësimi me nga një (1) anëtar për secilën KVV. KQZ siguron që funksioni i kryesuesit dhe i zyrtarit identifikues të ndahet në mënyrë të barabartë për të dy (2) subjektet politike garuese;
- 1.2. tre (3) anëtarët e tjerë të KVV, përfaqësojnë subjektet politike që nuk janë në raundin e dytë, por që kanë marrë numrin më të madh të votave në zgjedhjet e fundit parlamentare në atë komunë;
- 1.3. KQZ përmes KKZ kërkon nga subjektet politike, sipas nënparagrafit 1.1 dhe 1.2 të këtij neni, ta konfirmojnë listën e emëruar të anëtarëve të KVV nga raundi i parë dhe t'i propozojnë ndryshimet eventuale. KQZ miraton këto ndryshime, jo më vonë se njëzet (20) ditë para ditës së zgjedhjeve.

## **Neni 5**

### **Nominimet e KVV**

1. KQZ jo më vonë se njëzet e katër (24) orë pas certifikimit të subjekteve politike, miraton formulën e përbërjes dhe të ndarjes së vendeve në KVV.
2. Pas miratimit të formulës nga KQZ, SKQZ mënjëherë fton të gjitha subjektet politike të certifikuar, sipas nenit 2, 3 dhe 4 të kësaj Rregullore, të dorëzojnë në KKZ nominimet për anëtarë të KVV në komunat përkatëse.
3. Subjektet politike të certifikuar, nominimet e tyre për KVV të rregullta, KVV të ekipeve mobile dhe anëtarët rezervë, i dorëzojnë në KKZ në mënyrë elektronike dhe fizike, jo më vonë se pesë (5) ditë nga dita e pranimit të ftesës së bërë nga KQZ, Shtojca I – Formulari i nominimeve për KVV nga subjektet politike.
4. Formulari i nominimeve duhet të përmbajë:
  - 4.1. Emrin e komunës dhe kodin e komunës;
  - 4.2. emrin dhe akronimin e subjektit politik ose OJQ;
  - 4.3. emrin dhe numrin e QV;
  - 4.4. numrin e VV;
  - 4.5. funksionin në KVV;
  - 4.6. emrin dhe mbiemrin e të nominuarit;
  - 4.7. gjininë dhe datën e lindjes;
  - 4.8. numrin personal;
  - 4.9. numrin e telefonit;
  - 4.10. numrin e llogarisë bankare personale dhe emrin e bankës;

- 4.11. përvojën paraprake zgjedhore;
- 4.12. shkollimin;
- 4.13. emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e personit kontaktues të subjektit politik ose OJQ;
- 4.14. datën e dorëzimit të listës së nominimeve;
- 4.15. emrin, mbiemrin, nënshkrimin, datën e pranimit të listës së nominimeve dhe vulën nga KKZ.

## **Neni 6**

### **Kualifikimi dhe kriteret për emërim në KVV**

1. Asnjë person nuk mund të shërbejë si anëtar i KVV-së, nëse ai/ajo është:
  - 1.1. Kandidat për ndonjë post të zgjedhur publik në Kosovë;
  - 1.2. person pa të drejtë vote në Kosovë;
  - 1.3. person të cilit me vendim gjyqësor i është hequr zotësia e veprimit;
  - 1.4. anëtar i komisionit publik zgjedhor jashtë Kosovës;
  - 1.5. të cilit i është ndaluar shërbimi në cilësinë e anëtarit të KVV-së nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia apo që ka ndalesë me vendim të formës së prerë nga Gjykata Supreme,
  - 1.6. Anëtar i ndonjë institucioni ose organi zgjedhor;
  - 1.7. anëtar i OJQ që i monitoron zgjedhjet;
  - 1.8. i larguar nga puna nga administrata publike për shkelje të ligjit;
  - 1.9. i dënuar në tri (3) vitet e fundit me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale, me një ose më shumë vjet burgim efektiv;
  - 1.10. funksionar publik me status të veçantë në bazë të ligjit në fuqi për zyrtarët publikë, brenda ose jashtë Kosovës, nëse ka qenë në pesë (5) vitet e fundit.
2. KKZ, pas pranimit të listës së të nominuarve për KVV, shqyrton saktësinë e të dhënave të secilit anëtar të KVV, duke zbatuar rregullat si në vijim:
  - 2.1. Një subjekt politik nuk mund të ketë më shumë se një anëtar në KVV;
  - 2.2. nuk mund të emërohet më shumë se një person prej familjes së ngushtë në të njëjtin KVV, pavarësisht se mund të jenë nga subjekte politike të ndryshme (në familjarë të ngushtë përfshihen: bashkëshortët, fëmijët, prindërit, motrat dhe vëllezërit);
  - 2.3. të nominuarit emërohen në të njëjtën QV respektivisht VV ku janë regjistruar për të votuar apo të paktën në QV më të afërt ku ka për të votuar;

- 2.4. të nominuarit të jenë votues të regjistruar në të njëjtën komunë ku është QV/VV;
  - 2.5. të nominuarit të kenë aftësi të lexojnë dhe të shkruajnë në gjuhën e cila zyrtarisht përdoret në atë komunë;
  - 2.6. të nominuarit të kenë të përfunduar të paktën arsimim të mesëm;
  - 2.7. lista e të nominuarve, është në përputhje me formulën e përcaktuar nga KQZ.
3. Shërbimi ligjor i SKQZ obligohet që përmes institucioneve kompetente të bëjë verifikimin e pajtueshmërisë së kritereve për personat e nominuar, sipas nën paragrafit 1.5 dhe 1.9 të këtij neni.
  4. I nominuari obligohet që të nënshkruaj, Shtojca IV – Deklaratën nën betim, për përmbushjen e kritereve të përcaktuara sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni.

## **Neni 7**

### **Emërimi i anëtarëve të KVV**

1. Jo më vonë se 4 ditë kalendarike nga dita e pranimit të nominimeve, KKZ dërgon në KQZ listën e nominimeve sipas formulës në formë fizike dhe elektronike – Shtojca II – Lista e nominimeve për KVV nga KKZ në KQZ e cila përmban:
  - 1.1. Emrin e komunës dhe kodin e komunës;
  - 1.2. numrin rendor;
  - 1.3. emrin dhe mbiemrin e të nominuarit;
  - 1.4. numrin personal;
  - 1.5. datën e lindjes;
  - 1.6. gjininë;
  - 1.7. emrin dhe akronimin e subjektit politik ose OJQ;
  - 1.8. përvojën paraprake zgjedhore;
  - 1.9. shkollimin;
  - 1.10. emrin, numrin e QV dhe VV;
  - 1.11. funksionin në KVV;
  - 1.12. numrin e telefonit;
  - 1.13. emrin, mbiemrin, nënshkrimin, datën e dorëzimit të listës së nominimeve dhe vulën nga KKZ.
2. Menjëherë pas pranimit të listës së nominimeve nga KKZ, Shërbimi ligjor dërgon listën e të nominuarve për verifikimin e pajtueshmërisë së kritereve për personat e nominuar, sipas paragrafit 1 të nenit 6 të kësaj rregullore.

3. Jo më vonë se 2 ditë pas përfundimit të verifikimit, KQZ bën emërimin e KVV.
4. Pas emërimit, secili anëtar i KVV i cili kalon testin e trajnimit, është i obliguar që:
  - 4.1. Të nënshkruajë deklaratën nën betim;
  - 4.2. të nënshkruajë kodin e sjelljes – Shtojca III – Kodi i sjelljes për anëtarët e KVV;
  - 4.3. të nënshkruajë marrëveshjen e veçantë mbi shërbimin.
5. Kundër vendimit të KQZ për refuzim të emërimit të anëtarit të KVV, subjekti politik mund të parashtrijë ankesë në PZAP brenda dyzetëtetë (48) orëve.

## **Neni 8**

### **Përfundimi i mandatit dhe zëvendësimi i anëtarit të KVV**

1. KQZ mund të revokojë në çdo kohë, para nënshkrimit të kontratës, emërimin e secilit anëtar të KVV, nëse anëtari:
  - 1.1. Nuk merr pjesë në sesionet e trajnimit të organizuara nga KKZ;
  - 1.2. nuk mund ta kalojë testin pas sesionit të trajnimit.
2. Në rastet e parapara sipas nënparagrafit 1.1 dhe 1.2 të këtij neni, KQZ kërkon nga subjekti politik nominim të ri për plotësimin e listës së anëtarëve të KVV, në afat prej tri (3) ditëve.
3. Nëse subjekti politik i certifikuar nuk sjellë nominimin plotësues, KKZ menjëherë e bën zëvendësimin e anëtarit të KVV, nga lista rezervë e subjektit të njëjtë.
4. KKZ mund të revokojë në çdo kohë, pas nënshkrimit të kontratës, emërimin e secilit anëtar të KVV, nëse anëtari:
  - 4.1. Nuk paraqitet në punë një ditë para dhe në ditën e zgjedhjeve;
  - 4.2. vepron në kundërshtim me LZP, kodin e sjelljes dhe aktet tjera të KQZ;
  - 4.3. jep dorëheqje për shkaqe personale;
  - 4.4. kërkohet tërheqja apo zëvendësimi i tij nga subjekti që e ka nominuar;
  - 4.5. për çfarëdo arsye nuk është i gatshëm ose nuk ka mundësi të kryejë përgjegjësitë e veta, sipas nenit 10 të kësaj Rregullore.
5. Subjekti politik mund të kërkojë nga KKZ në çdo kohë zëvendësimin e anëtarit të KVV. KKZ bën zëvendësimin e anëtarit nga lista rezervë e subjektit politik.
6. E njëjta procedurë, e paraparë sipas këtij neni, vlen edhe për zëvendësimin e anëtarëve të KVV nga radhët e OJQ-së.

## Neni 9

### Funksionimi i KVV

1. VV hapet dhe funksionon me pjesëmarrjen e plotë të KVV, prej pesë (5) anëtarë.
2. Përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, në raste të mungesës së anëtarëve të KVV, KKZ me vendim mund të lejojë hapjen dhe funksionimin e VV me së paku tre (3) anëtarë të KVV.
3. KVV, gjatë procesit të votimit (ditës së zgjedhjeve), ka këto pozita/funksione:
  - 3.1. Kryesuesi i KVV, është përgjegjës për:
    - 3.1.1. Zbatimin e të gjitha procedurave të votimit, numërimit dhe paketimit;
    - 3.1.2. caktimin e detyrave anëtarëve të KVV;
    - 3.1.3. evidentimin në librin e votimit dhe raportimi i parregullsive në KKZ;
    - 3.1.4. evidentimin në librin e votimit i çdo ngjarje dhe procedurë brenda VV;
    - 3.1.5. evidentimin në librin e votimit dhe raportimi lidhur me pjesëmarrjen e votuesve në zgjedhje;
    - 3.1.6. menaxhon dhe mbikqyrë të gjitha operacionet brenda VV;
    - 3.1.7. kujdesin dhe ruajtjen e të gjithë materialit zgjedhor në VV.
  - 3.2. Kontrolluesi i rreshtit, është përgjegjës për:
    - 3.2.1. Konfirmimin e vendndodhjes së VV të votuesit;
    - 3.2.2. kontrollimin e gishtërinjëve të votuesit, për të konfirmuar se votuesi nuk ka shenjë të ngjyrës matrikuluese;
    - 3.2.3. të udhëzuar votuesin te zyrtaari i identifikimit;
    - 3.2.4. t'i dhënë përparësi të moshuarve dhe personave me nevoja të veçanta;
    - 3.2.5. menaxhimin e radhës së votuesve.
  - 3.3. Zyrtari i identifikimit, është përgjegjës për:
    - 3.3.1. Identifikimin e votuesit në Listën Votuesve (LV) dhe verifikimin e identitetit të votuesit, duke i krahasuar të dhënat personale dhe fotografinë në dokumentin identifikues;
    - 3.3.2. udhëzon votuesin të nënshkruhet në hapësirën e dedikuar në LV;
    - 3.3.3. e drejton votuesin te dhënësi i fletëvotimeve.
  - 3.4. Zyrtari i të dhënave statistikore, asiston zyrtarin e identifikimit dhe është përgjegjës për:
    - 3.4.1. Grumbullimin e të dhënave statistikore të daljes së votuesve, sipas gjinisë dhe grupmoshave;

- 3.4.2. raportimin e të dhënave statistikore të kryesuesit të VV.
- 3.5. Dhënësi i fletëvotimit, është përgjegjës për:
- 3.5.1. Shënjin me ngjyrë matrikuluese në gishtin e madh të dorës së djathtë të votuesit;
  - 3.5.2. vulosjen e fletëvotimit dhe dhënien e fletëvotimit votuesit;
  - 3.5.3. udhëzimin e votuesit për mënyrën e votimit;
  - 3.5.4. kontrollimin e fletëvotimeve të papërdorura, në rast se janë në gjendje të rregullt dhe i raporton kryesuesit të VV, nëse ka ndonjë fletëvotim të dëmtuar ose me gabime shtypi;
  - 3.5.5. numërimin e amave të fletëvotimeve dhe raportimin tek kryesuesi i VV për fletëvotimet e përdorura dhe të papërdorura;
  - 3.5.6. mbajtjen e fletëvotimeve në gjendje të rregullt dhe të sigurtë.
4. Në rastin kur kemi më shumë se pesë (5) anëtarë në një KVV, atëherë:
- 4.1. Anëtari i gjashtë (6) kryen funksionin e shënjesit të ngjyrës matrikuluese, sipas nënparagrafit 3.5.1. të këtij neni;
  - 4.2. anëtari i shtatë (7) kryen funksionin e mbikëqyrësit të kutisë së votimit, i cili ka për detyrë të sigurohet që votuesi ta vendosë fletëvotimin në kutinë përkatëse dhe se çdo fletëvotim është i vulosur sipas nënparagrafit 3.5.2. të këtij neni.
5. Në rast se mungon ndonjë prej anëtarëve të KVV, kryesuesi informon KKZ dhe kërkon zëvendësimin e tij/saj.

## **Neni 10**

### **Përgjegjësitë e anëtarëve të KVV para, gjatë dhe pas ditës së zgjedhjeve**

1. KVV ushtron veprimtarinë e vet në mënyrë profesionale, të paanshme dhe në shërbim të të gjithë votuesve.
2. Kryesuesi i KVV, bashkë me anëtarët e KVV, është përgjegjës për pranimin, mirëmbajtjen dhe kthimin e materialit zgjedhor të ndjeshëm dhe jo të ndjeshëm, të cilin e ka pranuar nga KKZ.
3. Kryesuesi siguron mbarëvajtjen e procesit të votimit. Anëtarët e KVV nuk mund të dalin apo të largohen nga VV dhe QV, pa lejen e kryesuesit të KVV, dhe se:
  - 3.1. Kryesuesi i KVV duhet të sigurojë që vetëm një anëtar i KVV mund të mungojë nga VV në të njëjtën kohë, për arsye të votimit;
  - 3.2. nëse mungon kryesuesi, atëherë KKZ autorizon njërin nga anëtarët e KVV që të kryejë detyrën e kryesuesit të VV përkohësisht, deri sa KKZ të bëjë zëvendësimin.



4. Gjatë ushtrimit të detyrës, anëtarët e KVV janë të detyruar të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentet e identifikimit (distinktivin).
5. Përgjegjësitë e kryesuesit dhe anëtarëve të KVV, para ditës së zgjedhjeve, janë:
  - 5.1. Pranimi dhe verifikimi i materialit zgjedhor;
  - 5.2. përgatitja dhe rregullimi i vendvotimit.
6. Përgjegjësitë e kryesuesit dhe anëtarëve të KVV, gjatë procesit të votimit në ditën e zgjedhjeve, janë:
  - 6.1. Pranimi i materialit të ndjeshëm zgjedhor në QKN;
  - 6.2. verifikimi i çdo materiali në VV;
  - 6.3. ndarja e detyrave për secilin anëtar;
  - 6.4. shpërndarja e materialit sipas detyrave të secilit anëtarë;
  - 6.5. regjistrimi i anëtarëve dhe vëzhguesve brenda VV, në librin e votimit;
  - 6.6. vendosjen dhe funksionalizimin e kamerave regjistruese;
  - 6.7. hapja e VV në ora shtatë (07:00h);
  - 6.8. raportimi lidhur me hapjen e VV;
  - 6.9. zbatimi i drejtë i procesit të votimit;
  - 6.10. evidentimi në librin e votimit dhe raportimi i parregullsive në KKZ;
  - 6.11. evidentimi në librin e votimit i çdo ngjarje dhe procedure brenda VV;
  - 6.12. evidentimi në librin e votimit dhe raportimi lidhur me pjesëmarrjen e votuesve në zgjedhje;
  - 6.13. mbyllja e kutisë dhe VV, evidentimi në librin e votimit dhe raportimi në KKZ.
7. Pas mbylljes së VV, KVV sigurohet që asnjë person i paautorizuar nuk hyn apo qëndron në VV.
8. Përgjegjësitë e kryesuesit dhe anëtarëve të KVV gjatë procesit të numërimit, i cili fillon tridhjetë minuta pas mbylljes së VV, janë:
  - 8.1. Rregullimi i hapësirës për numërim (tavolinat për numërim);
  - 8.2. ndarja e detyrave për secilin anëtar, për procesin e numërimit dhe evidentimi në librin e votimit dhe në formular;
  - 8.3. fillimi i numërimit dhe evidentimit të votave;
  - 8.4. evidentimi i rezultateve dhe shënimi në formularët përkatës;
  - 8.5. nënshkrimi i të gjithë anëtarëve të KVV në formularët, sipas funksionit;

- 8.6. fton zyrtarin e K-vote për marrje të rezultatit dhe skanim të formularit origjinal të rezultateve
  - 8.7. publikimi i formularit të rezultateve dhe raportimi te menaxheri i QV;
  - 8.8. paketimi i materialeve zgjedhore;
  - 8.9. paketimi i materialit administrativ;
  - 8.10. transportimi i materialit zgjedhor dhe administrativ në QKN.
9. Kryesuesi dhe anëtarët e KVV, pas ditës së zgjedhjeve, mund të kontaktohen nga KKZ, për sqarime dhe verifikime shtesë.

## **Neni 11**

### **Të drejtat e anëtarëve të KVV**

1. Anëtarët dhe kryesuesi i KVV kompensohen për kryerjen e detyrave të tyre me mjetet e ndara nga Buxheti i Republikës i Kosovës. KQZ nxjerr vendim të veçantë që rregullon kompenzimin e anëtarëve të KVV, duke u bazuar në:
  - 1.1. pjesëmarrjen në trajnime, sipas planit të aktiviteteve të KKZ;
  - 1.2. pranimin e materialit zgjedhor jo të ndjeshëm dhe rregullimin e Vendvotimit, një ditë para ditës së zgjedhjeve;
  - 1.3. në ditën e zgjedhjeve, deri në përfundimin e procesit të votimit dhe numërimit, ndërsa kryesuesit e KVV, deri në dorëzimin e materialit zgjedhor në QKN.
2. Anëtari i KVV ka të drejtë të fotografojë apo të përshkruajë formularët dhe librin e votimit, pa e cenuar ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Çdo anëtar i KVV, ka të drejtë të komunikojë dhe informojë KKZ, për çdo çështje që lidhet me procesin zgjedhor në VV.
4. Çdo anëtar i KVV, ka të drejtë të shënojë në librin e votimit vërejtje apo komente për rrjedhën e procesit në VV, apo të parashtrijë ankesë në PZAP.
5. Çdo anëtar i KVV duhet të njoftohet me vendimet e KQZ dhe KKZ.

## **Neni 12**

### **Votimi i anëtarëve të KVV**

Anëtarët dhe kryesuesi i KVV votojnë të parët, kur hapet VV. Nëse VV, në të cilin anëtari i KVV është caktuar të votojë është afër, kryesuesi i KVV mund t'ia lejojë anëtarit të KVV të largohet nga VV dhe të votojë, sipas procedurës së nënparagrafit 3.1 të nenit 10 të kësaj Rregullore.

## **Neni 13**

### **Vendimmarrja**

1. Në rastet kur vendimi është në kuadër të përgjegjësi të kryesuesit të KVV, vendimi i tij është përfundimtar në VV. Nëse ndonjë anëtar i KVV, ose vëzhgues i akredituar nuk pajtohet me vlerësimin apo vendimin e kryesuesit të KVV, ai mund të shënojë mospajtimin e tij në librin e votimit dhe mund të paraqesë ankesë në PZAP.
  - 1.1. Kryesuesi i KVV, është i obliguar t'i lejojë anëtarit apo vëzhguesit që të shkruajë komentin apo vërejtjen e tij në librin e votimit.
2. Vendimet e KVV merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve prezent në KVV.
3. Me pajtimin e anëtarëve të KVV, kryesuesi i KVV, nëse vlerëson se vëzhguesi i akredituar i pranishëm brenda në VV është duke penguar procesin e votimit apo numërimit, ai/ajo duhet t'i urdhërojë vëzhguesin që të largohet nga VV.
4. Në VV nuk lejohet të jenë prezent më shumë se një vëzhgues nga e njëjta organizatë vëzhguese në të njëjtën kohë.
5. Kryesuesi i KVV evidenton në librin e votimit arsyen e largimit të vëzhguesit nga VV.

## **Neni 14**

### **Dispozitat përfundimtare**

1. Çështjet që lidhen me punën e KVV, e që nuk janë të rregulluara me këtë Rregullore përcaktohen me vendim ose me ndonjë akt tjetër të KQZ, në përputhje me LZP.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja Nr.11/2023 për Këshillat e Vendvotimeve, e datës 09.03.2023.
3. Pjesë përbërëse të kësaj rregullore janë shtojcat:
  - 3.1. Shtojca I – Formulari i nominimeve për KVV nga subjektet politike;
  - 3.2. shtojca II – Lista e nominimeve për KVV nga KKZ në KQZ;
  - 3.3. shtojca III – Kodi i sjelljes për anëtarët e KVV;
  - 3.4. shtojca IV – Deklarata nën betim.

**Neni 15**

**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

**Kryesues**

**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

---

**Kreshnik Radoniqi**